



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

BURSA PASUNIVERSITARE MASTER NË INDONEZI

Ministria e Kërkimit, Teknologjisë dhe Arsimit të Lartë e Republikës së Indonezisë, në kuadër të Programit për Shkëmbimin Arsimor për vendet në zhvillim (Kemitraan Negara Berkembang, KNB) ofron 1 (një) bursë për studime pasuniversitare Master në një nga 15 universitetet e shquara të Indonezisë për studentët e huaj të vendeve në zhvillim.

Programi i Bursave KNB është lançuar për herë të parë në vitin 2007 dhe synon të kontribuojë në zhvillimin e burimeve njerëzore si pjesë e angazhimit për të përballuar sfidat globale ekonomike dhe sociale të vendeve në zhvillim. Në këtë kuptim, programi i bursave KNB ofron mundësi për studentët potencialë për të zhvilluar njohuritë dhe kompetencat e tyre. Deri në vitin 2015, numërohen 896 studentë nga 64 vende të botës, të cilëve iu është akorduar bursë studimi.

Objektivat e programit:

- Të kontribuojë në zhvillimin e burimeve njerëzore;
- Të nxisë një kuptim të gjithanshëm kulturor dhe të forcojë marrëdhëniet e bashkëpunimit mes vendeve në zhvillim.

Nga pala indoneziane kërkohet që kandidatët për studimet master të plotësojnë kushtet e domosdoshme për aplikim: të mos e kalojnë moshën 35, të kenë njohuritë e domosdoshme të gjuhës angleze dhe të jenë të pajisur me certifikatën e TOEFL-it, si dhe me certifikata të tjera për kualifikimet përkatëse. Bursa e studimit Master ofrohet në të gjitha degët e programet e studimit që përfshijnë fushat e shkencave sociale, të arsimit, shkencave natyrore, të inxhinierisë, si dhe disa degë të mjekësisë si: shëndeti publik, studime farmaceutike dhe infermieri, etj.

Bursa akordohet për tre vite (36 muaj) dhe mbulon shpenzimet e udhëtimit vajtje ardhje me avion, transportin e brendshëm, shpenzimet e qëndrimit e të ushqimit, shpenzimet për librat, si dhe shpenzimet për siguracionin shëndetësor.

Kandidatët për studime pasuniversitare do t'i nënshtrohen vitit përgatitor të gjuhës indoneziane, i cili fillon në shtator të vitit 2016.

Procedura e aplikimit bëhet përmes sistemit online dhe përfshin:

- a) Plotësimin e formularit të aplikimit, i cili gjendet në adresën e internetit: <http://knb.dikti.go.id>; Kandidatët, do të bëjnë fillimisht regjistrimin online. Pasi të kenë hyrë në sistem, kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit duke përcaktuar fushën e studimit;

b) Kandidatët, gjithashtu, duhet të shkarkojnë në sistemin online dokumentet përkatëse të cilat duhet të përkthehen paraprakisht në gjuhën angleze.

Përzgjedhja e kandidatit fitues për bursën e studimit do të bëhet nga pala indoneziane. Afati i fundit për aplikim është data **5 maj 2016**.

Bashkëlidhur këtij njoftimi ndodhen materialet informativë për kushtet dhe mënyrën e aplikimit. Për çdo informacion tjetër referojuni adresave në faqen e website:

<http://knb.dikti.go.id>;

Email : beasiswaknb@dikti.go.id;

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE